



29-11-2018

AAH

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:038750
 Datë: 08.11.2018
 Numri i dokumentit: 00165628

P.nr.972/2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] qe te dy nga Ferizaj, te akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.729-1/18 të dt.19.07.2018, për shkak se ne bashkëkryerje kane krye veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 para.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Avdullah Abedini dhe te akuzuarve, me dt. 08.11.2018 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. I pandehuri [REDACTED] me vendbanim në Ferizaj, rruga "[REDACTED]", i lindur me dt. [REDACTED], në Ferizaj, nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED], e vajzërisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, me profesion kamarier, i gjendjes se mesme ekonomike, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED] -

2. I pandehuri [REDACTED], me vendbanim ne Ferizaj rr. "[REDACTED]", nr. [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nena [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED] -

J A N E F A J T O R Ë

Sepse:

Me datën 31.03.2018 rreth orës 17:30, ne rrugën "Deshmoret e Kombit", ne oborrin e shkollës teknike "Jeronim De Rada", Ferizaj, te pandehurit pa autorizim kane poseduar narkotike, ne kuadër te planit operativ te policisë "Stop Drogave ne Shkolla", kane ndalu te

pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], ashtu që me rastin e kontrollit nga policia të njëjtëve iu kanë gjetur një sasi substance narkotike, të njëjtën policia e ka sekuestruar dhe pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka rezultuar se është Kanabis (Marihuane), me peshe prej 1.44 gram.

- me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i:

G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Të pandehurin [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë, do tas paguaj me këste për një periudhë prej 90 ditësh, mbështetur në nenin 46 par 2 të PKRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim

Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm

II. Të pandehurin [REDAKTUAR] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë, do tas paguaj me këste për një periudhë prej 90 ditësh, mbështetur në nenin 46 par 2 të PKRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim

Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm

Në baze të nenit 275 par 5 të KPRK-se gjykata i konfiskon substancën narkotike të llojit të bimës *canabis sativa* e gjetur në posedim të të pandehurit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.729-1/18 të dt.19.07.2018, ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dy me vendbanim në Ferizaj, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me neni 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 08.11.2018 konform nenit 245 të KPRK-se në të cilin Prokurori i Shtetit Avdullah Abedin lexoi akuzën dhe pas leximit të aktakuzës dhe pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën penale që akuzohet dhe si rrethanë lehtësuese ti merr pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përdore substanca narkotike.

I pandehuri [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar, me rastin e njohimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza dhe se i vjen keq për këtë veprë penale, se është përdorues i narkotikëve por që nuk merret me shitblerjen e tyre, kërkon falje publike dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysh këto rrethana dhe t'i shqiptoj një dënim sa më të bute.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar, me rastin e njohimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza dhe se i vjen keq për këtë veprë penale, se është përdorues i narkotikëve por që nuk merret me shitblerjen e tyre, kërkon falje publike dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysh këto rrethana dhe t'i shqiptoj një dënim sa më të bute.

Me që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së, pasi të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës, si kallëzimi penal i paraqitur nga Drejtoria për hetimin e trafikimit me narkotik numri i rastit 2017-DHTN-308 i datës 06.04.2018, raporti i ekspertimit i datës 18.07.2018, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të akuzuarve të datës 03.04.2018, vërtetimi mbi sekuestrimin e

përkohshme të sendeve i datës 31.03.2018 si dhe në të gjitha fotografitë dhe shkresat e tjera të bashkangjitura në dosjen e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të pandehurit, mori pranimin e fajësisë, pendimin e tyre për veprën që akuzohet, sjellja e tyre korrekte gjatë gjykimit, se është hera e parë që bien ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk kanë qenë të dënuar për vepra penale, premtimin se në të ardhmen do të kenë kujdes dhe nuk do të kryejnë vepra të tilla apo të ngjashme penale dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe u shqipton dënim me gjobë në si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, në shumë prej 150 /njëqind pesëdhjetë / Eurosh, duke qene i bindur se një dënim i tillë është në proporcion me shkallën e përgjegjësit penale, rrethanat të kryerjes se kësaj vepre dhe gjykata është e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj përgjithshme konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.972/18, me datë 08.11.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.